

KËRKESË
Nr. 1046/11, datë 23.12.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 384, datë 29.6.2023, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rehabilitimi i rrugës së ish-Repartit Ushtarak për në Aeroportin e Rinasit”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “arë”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1 005 312 (një milion e pesë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 384, DATË 29.6.2023, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-REPARTIT USHTARAK PËR NË AEROPORTIN E RINASIT”

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE							VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja e shpronësim (m²)	Çmimi (lekë/m²)	VLERA (m²)		
1	Balfin Construction,	Blendi	Hektor Fevzi	1669	241/6	Arc	89177.2	2.244	448	1,005,312	1,005,312	